



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2025:004397

Datë: 24.01.2025

Numri i dokumentit: 06753841

KF.nr.7/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, gjyqtarja Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar-administrativ të paditësit-propozuesit “Solvit” ShPK me numër unik identifikues 810820416 me seli në rr.”Jusuf Gërvalla” nr.32, Prishtinë, përfaqësuar nga avokat Ismet Musilu nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas propozimit - kërkesës së paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ - vendimit me nr.03.1.1-02024-15 të datës 19.07.2024, jashtë seancës, me datë 24.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë e palejueshme padia me numër KF.nr.7/25 e paditësit "Solvit" ShPK, me numër unik identifikues 810820416, me seli në rr. "Jusuf Gërvalla" nr. 32, Prishtinë, dhe propozimi – kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ – vendimit nr. 03.1.1-02024-15 të datës 19.07.2024, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak se padia është e parakohshme.

A r s y e t i m

"Paditësi, “Sedefi” Sh.P.K., përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka ushtruar padi më 10.01.2025 në këtë gjykatë, duke iniciuar këtë kontest tregtar-administrativ kundër të paditurës, Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me kërkesën për anulimin e vendimit .03.1.1-02024-15 të datës 19.07.2024. Po ashtu, paditësi me padi ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr. .03.1.1-02024-15 të datës 19.07.2024 deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes kryesore.

Më parashtrësën e datës 21.01.2025, paditësi, duke vepruar në përputhje me aktvendimin e Gjykatës me numër KF.nr.7/25, të datës 15.01.2024, ka sqaruar se ka shteruar të gjitha mjetet

juridike të rregullta. Ai ka deklaruar se më 11.11.2024 ka paraqitur një ankesë në Bordin e Ankesave pranë Ministrisë së Financave, Punëve dhe Transfereve, por nuk ka marrë asnjë përgjigje, pavarësisht kalimit të më shumë se 30 ditëve nga dorëzimi i saj. Paditësi ka theksuar gjithashtu se Bordi i Ankesave ende nuk është funksionalizuar, duke deklaruar se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për këtë organ nuk ka përfunduar. Për këtë arsye, ai konsideron se ka shteruar të gjitha mjetet juridike administrative.

Nga shqyrtimi i vendimit kontestues dhe shkresave të tjera të lëndës, rezulton se e paditura, Dogana e Kosovës, me vendimin nr. 01.3.2.2/18912 të datës 14.10.2024, ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin nr. 03.1.1-2024-15, të datës 19.07.2024 me të cilin e paditura ka obliguar paditësin të paguajë detyrime doganore shtesë, përfshirë taksën doganore, TVSH-në dhe kamatëvonesën mbi shumën e detyrimeve.

Gjykata konstaton se paditësi, më 11.11.2024, ka ushtruar ankesën në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendimin e të paditurës. Megjithatë, kjo ankesë është ende në pritje të shqyrtimit nga Bordi i Ankesave. Padia e paraqitur në gjykatë për anulimin e vendimit administrativ është bërë në një kohë kur procesi administrativ nuk është përmbyllur plotësisht.

Përmbajtja e padisë për anulimin e aktit administrativ është rregulluar sipas nenit 13 të Ligjit nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative (LKA) i aplikueshëm në rastin konkret, me të cilin përcaktohet se: *“Padia për anulimin e aktit administrativ mund të paraqitet për të sfiduar ligjshmërinë e aktit administrativ që cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të paditësit.”*Gjithashtu, neni 14 përcakton që: *“Me padinë e anulimit, paditësi kërkon anulimin e pjesshëm ose të plotë të një akti administrativ, që ai pretendon se është i paligjshëm dhe i cenon të drejtat apo interesat e tij të ligjshme. 2. Anulimi i pjesshëm mund të përfshijë edhe ndryshimin e pjesshëm të një akti administrativ, kur ai vendos një detyrim financiar në ngarkim të paditësit, duke zvogëluar masën*

Kushtet për lejueshmërinë e padisë janë rregulluar në nenin 17 të Ligjit për Konfliktet Administrative ku specifikohet: *“1. Padia mund të paraqitet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike administrative të rregullta, përveç rasteve kur: 1.1. akti administrativ lëshohet nga organi epror i organit administrativ që ka marrë vendimin në shkallë të parë; 1.2. pala e tretë pretendon se i janë cenuar të drejtat nga një akt administrativ; 1.3. me ligj të veçantë parashihet përjashtimi nga shterimi i mjeteve juridike administrative.”*

Në këtë rast, paditësi ka ushtruar ankesë në organin kompetent, përkatësisht në Bordin e Ankesave, më datën 11.11.2024. Megjithatë, duke marrë parasysh deklaratën e paditësit dhe provat e dorëzuara, procesi i shqyrtimit të kësaj anekese ende nuk ka përfunduar.

Gjykata pati parasysh pretendimin e paditësit se Bordi i Ankesave nuk është funksional për shkak të mungesës së përfundimit të procesit të përzgjedhjes së anëtarëve. Megjithatë, duke iu referuar rrethanave faktike të njohura gjykatës, ky bord tashmë është funksional dhe duhet të shqyrtojë ankesën e paditësit brenda afateve ligjore.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 17 të ligjit, gjykata konstaton se paditësi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike administrative dhe, si rrjedhojë, padia është e parakohshme. Vetëm paraqitja e ankesës dhe mosveprimi i organit përkatës sipas ankesës nuk krijojnë të drejtën për paraqitjen e padisë për anulim.

Rrjedhimisht, vendimi i atakuar rezulton të mos i përmbushë kushtet e lartcekura në nenin 17 të LKA-së.

Gjykata sqaron se Ligji për Konfliktet Administrative parashikon mundësinë e ushtrimit të padisë për nxjerrjen e aktit administrativ në rastet kur organi administrativ nuk ka marrë vendim brenda afateve të përcaktuara. Konkretisht, neni 15 i këtij ligji përcakton: “1. *Paditësi mund të paraqesë padi për nxjerrjen e aktit administrativ në rastet kur organi administrativ nuk ka marrë vendimin e kërkuar brenda afatit të paraparë me ligj.* 2. *Nëse akti administrativ nuk nxirret brenda afatit të ligjshëm, kjo konsiderohet refuzim i heshtur.*”

Rrjedhimisht, për paditësin në rastin konkret, ligji i lejon ushtrimin e padisë për nxjerrjen e aktit administrativ. Megjithatë, duke qenë se paditësi, në vend të kësaj mundësie të paraparë me ligj, ka ushtruar padi për anulimin e aktit administrativ, Gjykata nuk e ka trajtuar çështjen në përputhje me nenin 15, por në përputhje me nenin 14 lidhur me nenin 17 par 1 të LKA-së.

Paditësi me padi ka propozuar gjithashtu shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të kontestuar deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes kryesore.

Masat e sigurimit të padisë janë rregulluar me nenin 99 të LKA-së, ku ndër të tjera përcaktohet se: *1. Për sigurimin e padisë në rastin e padive për anulimin e një akti administrativ sipas nenit 14 të këtij Ligji apo një padie për ndalimin e kryerjes të një veprimi tjetër administrativ sipas nën paragrafit 1.1 të nenit 16 të këtij Ligji, Gjykata, me kërkesë, mund të vendosë pezullimin e zbatimit të aktit apo përkatësisht ndalimin e menjëhershëm të veprimit tjetër administrativ. 2. Për sigurimin e padisë në rastin e padive për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ administrativ, Gjykata me kërkesë, mund të vendosë për moszbatimin apo ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të aktit nënligjor normativ [...]*”

Gjykata vlerëson se as kërkesa për masë në këtë fazë nuk mund të shqyrtohet, meqenëse e njëjta është e lidhur me padinë, e cila rezulton të jetë e palejueshme.

Andaj, në përputhje me nenin 38, paragrafi 1, pika 1.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, që përcakton se: *. Gjykata hedh poshtë padinë, si të palejueshme për gjykim në themel, nëse në gjykimin e saj, rezulton se: 1.1. padia është e parakohshme ose është paraqitur pas kalimit të afatit – padia jashtë afatit;”*,” Gjykata konstaton se padia dhe kërkesa për masë të posaçme janë të parakohshme. Për këtë arsye, padia dhe kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit hedhen poshtë të palejueshme.

Nga të lartcekurat, gjykata, në përputhje me nenin 38, paragrafi 1, pika 1.1 të LKA-së, vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti Fiskal

KF.nr.7/25, datë 24.01.2025

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.